

PROCES VERBAL- Tipi i kontratës -

"Blerje materiale ndertimi e hidraulike"

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Blerje materiale ndertimi e hidraulike "

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale ndertimi 44111000-1, materiale hidraulike 44115210-4

VLERA E FONDIT LIMIT:

2 500 000 (dymilion e peseqind mije) Leke pa T.V.SH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Sarande ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 e 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021,2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" , ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të

ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqese vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" është përcaktuar që kontratat e mallrave të mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3.2 Operatorët ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

-Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deshmojnë se i plotesojnë specifikimet për mallrat e percaktuara në listën e autoritetit Kontraktor, e për këtë ata duhet të paraqesin mostrat për secilin mall të kërkuar, fotografi apo kataloge, si dhe deshmi për rezultatet e testimeve zyrtare të leshuara nga institucione të autorizuar.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera noteriale 1 (një) mjet transporti mallrash me kapacitet jo më pak se 1,5 (një presje pese) Ton.

Per plotesimin e kriterit të mesipër të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit). Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë percaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në zbatim të ketyre ndryshimeve ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm), e) foto e automjetit.

Për mjetin e marre me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm), e) foto e automjetit. Mjetet të shoqerohen me kontratën përkatëse të qerës/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion një mjet transporti me kapacitet mbajtes jo më pak se 1,5 ton, i nevojshëm për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te deklaroje nje ambjent ne pronesi te vet per magazinimin e perkohshem te materialeve te ndertimit si rere,çimento,gelqere dhe pllaka brenda teritorit te Bashkise Sarande ku shtrin aktivitetin Ndermarja e Sherbimeve Sarande,ose te kete kontrate noteriale qeraje me nje operator tjeter ne nje afat kohor minimum 1 (nje) vit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion nje ambjent magazinimi i perkohshem per disa materiale ndertimi per te cilat Ndermarrja nuk ka siperfaqe per magazinim dhe do te meren nga operatori sipas nje grafiku dhe proces verbali ne menyre periodike mujore.

Specifikime teknike

- Çimento e zeze per beton dhe llaç:

Paketimi ne thase 50kg EN 197-1 Klasa 32.5R

- Marmaro:

Pluhur mermeri I bardhe Paketimi 20 kg.

- Gelqere e shuar:

Paketimi 10kg ne qeska

- Tel xingato:

Materiali xingato spesor 2 dhe 3 mm

- Hekuri I ndertimit:

Ø 8,10,12, shufra me gjatesi 6 ml dhe Klasa B500C

- Tubo e zeze hekuri ø 60 me spesor 2mm gjatesia 6ml



- Binare druri 7.5x7.5cm gjatesi 3ml



- Tavan druri importi me trashesi 1.25mm



- Drrase vendi bredhi e pa planuar 2.5x10cm 4m gjatesi



- Gozhde ndertimi:

Gjatesi 4-10cm ne pako 5kg materiali celik

- Gozhde betoni:

Diametri deri ne 3.5mm dhe gjatesi 5-8 cm,Materiali I zinkuar,Paketimi 100cope.

- Tulla bari:

Permasat 9x12x20 cm,materiali qeramike,paketimi ne baleta saisa 500 cope

- Blloqe betoni:

Permasat 16x16x36cm ,materiali beton,paketimi ne baleta sasia 100cope

- Ne seksionin e pllakave te betonit :

Permasat jane te specifikuara ne preventiv sipas pllakave, paketimi ne baleta 1 m3 pllakat jane nga njera ane me dekor.

Pllaka 40x40x2.5cm ngjyre gri.



Pllaka 20x10x5.5cm ngjyre gri

- Pllake guri e kuqe gur natyral me trashesi 3 cm e crregullt jo e prere ne makineri.
- Koll Pllakash me baze cemento paketimi 25kg mbulimi 3-5kg/m² Forca ngjitëse në beton : ≥ 1.0 N/mm² Rezistenca në shtypje : ≥ 10 N/mm²,Stuko pllakash me baze cemento paketimi 5kg fortesia 6N/mm².
- Stuko muri paketim 20-25kg Forca ngjitëse në beton : $\geq 0,5$ N/mm².
- Stuko druri paketim 200g ngjyre e bardhe dhe kafe.
- Ngjites druri paktim 500g
- Boje vaji ne paketim 5 litra dhe ngjyrat sipas kerkeses se Ndermarrjes

Mbulimi : per mbulim te plote 10-12 m²/l,Hollimi : Me 15-20 % ne volum,Koha e tharjes : Koha e plote e tharjes 10 min Dora e dyte 8 oresh

- Boje hidropastike me baze uji e bardhe mbulimi 10-12 m²/l koha e tharjes 3-4 ore hollimi 10-15% uje paketimi kova 9-15l
- Boje akrilike me baze uji e bardhe mbulimi 10-12 m²/l koha e tharjes 3-4 ore hollimi 10-15% uje paketimi kova 9-15l
- Pigmente boje plastike ne paketime 250g me ngjyra te ndryshme sipas kerkeses se Ndermarrjes.
- Boje fosfoeshente per sinjalistiken rrugore me rezinë akrilike speciale me bazë solventi.Mbulimi 1.7m²/kg,Paketimi 25kg,Koha e tharjes max 25min,ngjyrat dhe sasite sipas preventivit.
- Dylent solvent per bojera dhe primera paktimi 5litra.
- Rula me bisht per boje plastike dhe vaji permasat 5,10,12,18cm



- Furca per boje vaji dhe plastike 18-60mm



- Furca me kend te levizshem me vide 50 mm



- Zgjatues metalik alumin per lysterje rrula dhe furca 2m



- Mbajttese plastike per boje 26x32 cm



- Leter zmerile 40,60,80 paketimi rolo
- Shirit ngjites Tenie leter 50mmx50m



- Goma karroce ndertimi tubolare



- Ripa ngarkese me krikete dhe ganxha 10ml gjatesi dhe 4cm gjeresi



- Vida veteshpuese 3x35mm,3x45 mm me paketim 500 cope/pako sejcila



- Vida me koke ekzagonal 10x100mm



- Rekorderi \varnothing 20,25 HDPE sipas preventivit nga nr.42 deri 53 rendor

Materiali polietilen, Presioni 6 dhe 10 bar sipas preventivit

- Rubineta bronzi me leve 1/2,3/4

Lartësia: 105mm,Gjatësia: 140mm



- Sarçinesk , Presioni i ujit: PN-30,lidhja me rrjetin: 1/2" dhe 3/4",
Materiali: Bronzi, Lidhja: F-F



- Kapak pusete gize \varnothing 60



- Çekiç I vogel mekaniku

Materiali : Çelik/Bisht druri, Pesha : 200gr00 gr



- Çekiç I vogel guri muratori 600gr

Materiali : Çelik/Dru,Pesha : 600 gr

- Dalte per gdhendje guri me mbrojtese plastike

Materiali : Çelik

- Nivel alumini

Gjatësia :100cm,Materiali : Alumin,Tregues Niveli : 3

- Meter muratori 2ml gjatesi



- Sharre dore druri stanley 50 cm



- Malla plastike llaci me doreze

Gjatësia : 270mm,Gjerësia : 180mm,Materiali : Plastik



- Fartase (perdaf) 32x18 cm

Gjatësia : 320mm,Gjerësia : 180mm,Lartësia : 15mm,Materiali : Polisterol



- Shpatulla celiku me doreze druri

Materiali : Inoks,Masa : 16cm



- Sqepar ndertimi me bisht

Materiali : Celik/Dru,Masa : 450 g



- Mastar alumini 3ml

Gjatësia : 300cm,Materiali : Alumin

- Lama sharre druri

Materiali : Celik,Masa : 60cm



- Çizme llastiku

Rezistente ndaj ujit : PO,Materiali : PVC,Masa : 40-42



- Pelerine shiu pvc

Materiali : Poliester/PVC,Përmasat : 115x78 cm



NJESIA E PROKURIMIT

ELJON MAHMUTAJ

ANIJA VJERI

MANOL KOLOI